

VENDIM
Nr. 289, datë 17.5.2023

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI PJESË E FORCËS SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE (MULTINATIONAL FORCE AND OBSERVERS, MFO), NË SINAI, REPUBLIKA ARABE E EGJIPTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e 3 (tre) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (*Multinational Force and Observers, MFO*), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit.

2. Misioni i ushtarakëve është vëzhgimi i implementimit të masave të sigurisë të Traktatit të Paqes ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, të datës 26 mars 1979.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 (tre) vjet, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit për në mision.

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së misionit për ditët në udhëtim;

ç) transport të personelit;

d) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

5. Transporti i personelit që shërben në Sinai, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër përballimin e këtyre shpenzimeve.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara në programin “Forca e luftimit”.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku